



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.803/15 prot.

Datë 09.05.2025

V E N D I M

Nr. 640/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.05.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.562/2024, datë 25.04.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol

Ankimues: Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me NIPT K71903025A dhe adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Albpetrol, me adresë: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 25.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 562/2025 ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.*
2. *Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht Vendimin Nr. 454/2025, datë 09.04.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.*
3. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 1558/8 prot., datë 05.05.2025, protokolluar me tonën nr. 803/12 prot., datë 08.05.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP nr. 562/2025 datë 25.05.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1558/8 prot., datë 05.05.2025, protokolluar me tonën nr. 803/12 prot., datë 08.05.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP nr. 562/2025 datë 25.05.2025.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se, autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit të KPP-së nr.562/2025 datë 25.05.2025 ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik shtojcën e datës 05.05.2025 e cila është në përputhje me vendimin më sipër të KPP-së.

II.3. Sa më sipër KPP, vëren se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimet e KPP nr.454/2025 datë 09.04.2025 dhe nr. 562/2025 datë 25.05.2025 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

